

Raport i Konsultimit për projektligjin “Për Burimet Ujore”

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për Burimet Ujore”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Për këtë projektligj janë zhvilluar edhe konsultime në fazën paraprake përmes ngritjes së Grupit Ndërinstitucional të Punës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.24 datë 9.02.2021, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”, i cili kishte si objekt veprimtarie finalizimit e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore.

Takimet e grupeve të punës, për konsultimin e projektligjit “Për Burimet Ujore” nen për nen janë zhvilluar gjatë nga prilli 2021 dhe kanë vijuar edhe gjatë 2022, (8 takime në total).

Konsultimi i Projektligjit “Për Burimet Ujore” në RNJEK pati një kohëzgjatje prej 40 ditësh nga data e publikimit specifikisht filloi në datë 27.05.2022 dhe u mbyll më datë 21.07.2022.

Gjithashtu janë realizuan edhe takime konsultuese në nivel ekspertësh në çdo Këshill Baseni Lumor, përkatësisht sipas rendit në vijim:

1. Takim konsultues në KBU Drin - Bunë, datë 22 qershor 2022;
2. Takim konsultues në KBU Mat date 23 qershor 2022;
3. Takim konsultues në KBU Erzen date 24 qershor 2022;
4. Takim konsultues në KBU Ishëm datë 27 qershor 2022;
5. Takim konsultues në KBU Seman date 30 qershor 2022;
6. Takim konsultues në KBU Shkumbin date 4 korrik 2022;
7. Takim konsultues në KBU Vjosë date 6 korrik 2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve

këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin "Për Burimet Ujore" ishin katër:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK;
2. Takime konsultuese në çdo KBU;
3. E-mail;
4. Konsultimit përmes publikimit në faqen zyrtare të AMBU-së.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

Anëtarët e grupit të ndërinstitucional punës në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr.24 datë 9.02.2021:

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
- Ekspertët e projektit EUSIWM, të cilët kanë përgatitur draftet fillestare të projektligjeve.

Gjithashtu gjatë fazës së organizimit të takimeve konsultuese në nivel Këshilli Baseni Ujor, morën pjesë anëtarët e këtyre këshillave (përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe grupe interesi) si dhe u ftuan përfaqësues të universiteteve dhe organizata jo fitimprurëse objekti i veprimtarisë së të cilave lidhet me burimet ujore;

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</i>	<i>Justifikimi</i>

Lidhur me rezultatet e konsultimeve, përsa i përket RENJK nuk ka pasur komente lidhur me projektaktin e propozuar.

Ndërsa në takimet e zhvilluara në nivel KBU-je, komentet e adresuara kanë qenë të lidhura kryesisht me aspektet e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit. Në tërësi përfaqësojnë ndaj ligjit të ri ka qenë pozitive.